



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 142, datë 29.8.2025

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR HARTIMIN E NJË PLANI VEPRIMI ME MASA
PËR TË SIGURUAR PROGRES QË SHQIPËRIA TË KLASIFIKOHET
SI NJË INOVATOR MESATAR NË TABELËN EVROPIANE
TË REZULTATEVE TË INOVACIONIT, ME REZULTAT
NË PËRMIRËSIMIN E RAPORTIMIT TË SHQIPËRISË
PËR TREGUESIT TEI, NË KUADËR TË DOKUMENTIT
TË POLITIKËS “AGJENDA KOMBËTARE E REFORMAVE
2024-2027”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 12, pika 1, e 28, shkronja “d”, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe bazuar në vendimin nr.621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor””,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e një plani veprimi me masa për të siguruar progres që Shqipëria të klasifikohet si një inovator mesatar në Tabelën Evropiane të Rezultateve të Inovacionit (*European Innovation Scoreboard*), me rezultat në përmirësimin e raportimit të Shqipërisë për treguesit TEI, në kuadër të zbatimit të reformës 2.3.1 (hapi 4), të dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027”.

2. Grupi ndërinstitutional i punës, në vijim GNP, të kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për inovacionin, në përputhje edhe me përgjegjësitë e parashikuara për këtë hap në vendimin nr.621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, dhe të ketë përbërjen, si më poshtë vijon:

- a) Ministria përgjegjëse për ekonominë, kulturën dhe inovacionin, 5 anëtarë;
- b) Ministri përgjegjës për sipërmarrjen dhe klimën e biznesit, 1 anëtar;
- c) Ministria përgjegjëse për arsimin, 1 anëtar;
- ç) Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, 1 anëtar;
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, 1 anëtar;
- dh) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, 1 anëtar;
- e) Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, 2 anëtarë;
- ë) Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve, 1 anëtar;
- f) Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës, 1 anëtar.

Anëtarët e GNP-së duhet të jenë nëpunës të nivelit “drejtor i përgjithshëm” ose “drejtor drejtorie”.

3. Në mbledhjet e GNP-së mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga INSTAT-i, institucione të tjera qendrore, si dhe ekspertë të jashtëm që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtij grupi.

4. Veprimtaria e GNP-së, në kuadër të hartimit e të miratimit të planit të veprimit për zbatimin e hapit 4, të reformës 2.3.1, duhet të përmbushë objektivat e mëposhtëm, në përputhje me afatet e përcaktuara:

- a) Të sigurohet koordinimi ndërinstitutional për mbledhjen e të dhënave dhe politikëbërjen mbi inovacionin në përputhje me Tabelën Evropiane të Inovacionit (EIS), përmes angazhimit të aktorëve kyç, organizimit të konsultimeve dhe komunikimit të hershëm me Komisionin Evropian për sqarimin e treguesve dhe metodologjisë.
- b) Të kryhet analiza e statusit të Shqipërisë në EIS dhe të hartohen dokumente orientuese të politikave, përmes vlerësimit të boshllëqeve në të dhëna, prioritizimit të ndërhyrjeve dhe konsultimeve me Komisionin Evropian për përmirësimin e renditjes dhe përcaktimin e veprimeve të mëtejshme;
- c) Të identifikohen dhe të vlerësohen iniciativat kërkimore, inovative dhe teknologjike me ndikim në treguesit EIS, përmes menaxhimit të portofolit dhe përmirësimit të koordinimit ndërinstitutional për rritjen e efektivitetit dhe shmangien e mbivendosjeve;

- ç) Të identifikohen dhe të vlerësohen iniciativat kërkimore, inovative dhe teknologjike në funksion të treguesve EIS, duke ndjekur qasjen e menaxhimit të portofolit për prioritizimin e ndërhyrjeve me ndikim të lartë dhe forcimin e koordinimit ndërinstitucional;
- d) Të finalizohet dokumenti orientues i politikave dhe të hartohet plani i veprimit me masa konkrete, afate dhe përgjegjësi institucionale, për të udhëhequr përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në Tabelën Evropiane të Inovacionit (EIS, dhjetor 2025).
5. Pranë grupit ndërinstitucional të punës të funksionojë si sekretariat teknik drejtorja e përgjithshme, përgjegjëse për çështjet e inovacionit në ministrinë përgjegjëse për ekonominë, kulturën dhe inovacionin, e cila ka përgjegjësitë e mëposhtme:
- a) Menaxhon organizimin e mbledhjeve të grupit ndërinstitucional të punës;
- b) Përpunon materialin e grupit ndërinstitucional të punës që do të përdoret për takimet e tij;
- c) Organizon takime në nivel teknik me të gjitha palët e interesuara;
- ç) Lehtëson bashkëpunimin dhe koordinimin brenda grupit ndërinstitucional të punës.
6. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të dërgojnë brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre, pranë ministrisë përgjegjëse për ekonominë, kulturën dhe inovacionin.
7. Ngarkohet kryetari i grupit që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së grupit.
8. Ngarkohen institucionet sipas pikës 2 për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA